

Mirë se vini në rrjetin e bibliotekave komunale të qytetit të Gjenevës!

Ju kërkoni një libër, një CD, një DVD për ju, për fëmijët tuaj? Dëshironi të shkoni në një vend të ngrohtë dhe mikpritës për të kryer kërkime në internet, për të konsultuar postën tuaj elektronike? Dëshironi të pini një kafe duke lexuar gazetën tuaj të preferuar? Bibliotekat e qytetit të Gjenevës ju hapin portat e tyre dhe është falas. Do të gjeni atje më shumë se 500.000 libra dhe dokumente, 80.000 CD dhe 50.000 DVD. Libra të shumtë, revista, DVD, gazeta, etj. janë të disponueshme në shumë gjuhë dhe veçanërisht në anglisht, gjermanisht, rusisht, arabisht, spanjisht, italisht, portugalisht dhe shqip. Bibliotekarët që punojnë atje janë persona të disponueshëm për t'ju informuar dhe orientuar në kërkimet tuaja. Ju jeni të mirëpritura dhe të mirëpritur në bibliotekat tuaja të qytetit të Gjenevës. Mos prisni më, ejani të na vizitoni!

Sami Kanaan

Këshilltar administrativ në detyrë
i Departamentit të Kulturës dhe Sportit

Rrjeti i B.N.J.A-ve



Rrjeti i B.N.J.A-ve përbëhet nga 7 biblioteka, një shërbim të bibliotekës shëtitëse, si dhe një shërbim në banesë. Ai ofron hapësira për personat madhorë dhe hapësira për adoleshentët të cilat mundësojnë konsultimin dhe huazimin e dokumenteve mbi të gjitha subjektet dhe materialet për qëllime informimi, edukimi, kulture dhe argëtimi. B.N.J.A-të janë të pranishme në thuajse të gjitha lagjet e qytetit.

Si të hyjmë në rrjetin e B.NJ.A-ve?

Aksesi në koleksionet dhe huazimet në rrjetin e B.NJ.A-ve janë të lira dhe falas. Huazimi i të gjitha dokumenteve të B.NJ.A-ve është gjithashtu falas, por është subjekt i një regjistrimi, me paraqitjen e një dokumenti identifikimi. Regjistrimi i të miturve/-ave kërkon autorizimin (nënshkrimin) e prindërve ose të përfaqësuesit/-es të/së tyre ligjor/-e. Një kartë anëtarësie ju dërgohet në këtë rast në banesën tuaj përmes postës.

Regjistrimi i rezervohet personave me banim në kantonin e Gjenevës ose kudo ku komuna ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti me qytetin e Gjenevës¹.

Koordinatat e plota (adresë, oraret e hapjes, telefoni) janë të detajuara në dokumentin «Oraret», si dhe në faqen e internetit të B.NJ.A-ve: www.bm-geneve.ch

Çfare koleksionesh shumëgjuheshë propozohen B.NJ.A-të?

PËR PERSONAT MADHORË:

- **romane:** anglisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, portugalisht
- **shtypi i shkruar:** anglisht, gjermanisht, rusisht², arabisht², spanjisht, italisht, portugalisht
- **shtypi në internet:** më shumë se 5000 tituj në gjuhët e huaja të 100 shteteve
- **libra të lexuar²** në anglisht dhe gjermanisht

PËR TË RINJTË:

- **libra:** anglisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, portugalisht, arabisht, shqip, rusisht

B.NJ.A-të propozojnë gjithashtu metoda të mësimin të gjuhëve (nga frëngjishtja në gjuhë të huaja ose mësim të gjuhës frënge).

Nga se përbëhen koleksionet e B.NJ.A-ve?

B.NJ.A-të propozojnë për çdo moshë:

- dokumentarë
- romane
- libra komikë
- albume
- revista dhe gazeta të përditshme
- romane me shkronja të mëdha
- koleksione muzikore
- koleksione multimediatike (filma fantastiko-shkencorë, dokumentarë, libra të lexuar, metoda gjuhësh)
- burime numerike (shtypi)

Çfarë shërbimesh ofrojnë B.NJ.A-të?

B.NJ.A-të ofrojnë poste pune, leximi dhe dëgjimi, si dhe lidhjet në rrjetin Wifi. Ju mund të keni akses gjithashtu në kënde interneti të cilat është e mundur të rezervohen paraprakisht në vend ose me telefon për një sesion 45 minutash.

Gjatë gjithë vitit, ofrohen për të gjithë publikun shumë aktivitete kulturore falas, si dhe atelie formimi: konsultoni axhendën ose faqen e internetit të B.NJ.A-ve për t'i zbuluar ato!

Bibliografi, diskografi, si dhe blog-e (blog-bmgeneve.ch/) janë në dispozicionin tuaj për t'ju bërë të zbuloni përzgjedhjet tematike të dokumenteve.

Katalogun në faqen e internetit: <https://collectionsbmu.ville-ge.ch/> ju lejon të keni akses në tërësinë e koleksioneve të B.NJ.A-ve, si dhe në opsionin «Hapësira ime» për të menaxhuar huazimet në distancë. Kodi i aksesit do t'ju transmetohet me marrjen e kartës tuaj të anëtarësisë.

Profesionistët e rrjetit të B.NJ.A-ve janë në dispozicionin tuaj për t'ju përgjigjur të gjitha pyetjeve tuaja dhe për t'ju shoqëruar në kërkimet tuaja.

¹ Nyon, Ambilly, Annemasse, Collines du Léman, Divonne-les-Bains, Evian, Gex, Lucinges, Saint-Genis-Pouilly, Thonon-les-Bains, Saint-Cergues (FR) Saint-Julien-en-Genevois, Veigy-Foncenex, Ville-la-Grand

² E disponueshme vetëm në Bibliotekën e Cité